

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-110929
Më 19.8.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve financiare për OJQ "Leos Art", kryetari i Komunës, më 19 gusht 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e OJQ "Leos Art" nga Prizreni, për lejimin e mjeteve financiare për organizimin e Festivalit tradicional "Skulptfest", që do të mbahet me nga data 3-7.9.2014 në Prizren, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet në shumën 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OJQ "Leos Art" si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-110922
Më 19.8.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve financiare për OJQ "Akea", kryetari i Komunës, më 19 gusht 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e OJQ "Akea" nga Prizreni, për lejimin e mjeteve financiare për organizimin e edicionit të gjashtë të "Panairit të Librit-Prizreni 2014", që do të mbahet me nga data 25-31.8.2014 në Prizren, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet në shumën 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OJQ "Akea", si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja